

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

R R E G U L L O R E

PËR LIÇENCIMIN
E TREGUT TË LETRAVE ME VLERË

Miratuar me vendimin e Bordit nr.12, datë 29.01.2007

Kjo rregullore hartohet në bazë të Nenit 66 (1) të Ligjit Nr. 8080, datë 01.03.1996, “Për Letrat me Vlerë”.

KREU I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti i rregullores

Kjo rregullore ka si objekt përcaktimin e kërkesave, afateve dhe procedurave të liçencimit, të cilat duhen ndjekur nga subjektet që aplikojnë për tu pajisur me liçencë për të vepruar si treg letrash me vlerë.

Neni 2
Kufizime te aktivitetit

Asnjë subjekt nuk mund të zhvillojë aktivitet si treg letrash me vlerë, nëse nuk është liçencuar më parë nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Neni 3
Përkufizime

Përkufizimi për tregun e letrave me vlerë dhe përkufizimet e tjera të nenit 2 të ligjit nr. 8080 "Për letrat me vlerë" si dhe emetimet në ligjin 9572, datë 3.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, zbatohen njëjloj për qëllimet e interpretimit të këtyre rregullave.

Neni 4
Funksionet e tregut të letrave me vlerë

Tregu i letrave me vlerë, ka si funksion të tij përqëndrimin e kërkesës dhe ofertës për letra me vlerë, nëpërmjet krijimit të një strukture të përshtatshme dhe sigurimit e mirëmbajtjes të pajisjeve të nevojshme, për të arritur një kuotim universal të letrave me vlerë, me qëllim lehtësimin e lëvizjes së kapitalit dhe vlerësimin real të tij. Për arritjen e këtij qëllimi, tregu i letrave me vlerë duhet të sigurojë:

- a) Vazhdimësinë e transaksioneve të kryera;
- b) Të drejta të njëjta për të gjithë anëtarët e tregut të letrave me vlerë;
- c) Të drejta të njëjta për të gjithë emetuesit e letrave me vlerë;
- d) Shpërndarja e një informacioni uniform për kuotimet dhe volumin e tregtimit të letrave me vlerë në treg.

KREU II STATUTI DHE RREGULLAT E TREGUT

Neni 5 Miratimi i statutit dhe i rregullave të tregut

Tregu i letrave me Vlerë e organizon veprimtarinë e tij mbi bazën e statutit dhe rregullave të funksionit të tregut, të cilat i nënshtrohen miratimit nga ana e Bordit të Autoritetit.

Projektstatuti i një shoqërie që ka për objekt të aktivitetit të saj aktivitetin si Treg i Letrave me Vlerë, përpara se të depozitohet në Regjistrin Tregtar, duhet t'i paraqitet Autoritetit.

Projekti shoqërohet me një kërkesë zyrtare, me anë të të cilës kërkohet miratimi nga Autoriteti.

Përpara mbërritjes në Autoritet, praktika i nënshtrohet të njëjtës procedurë të parashikuar në nenin 9 e 10 të kësaj Rregullore.

Bordi i Autoritetit në mbledhjen e tij më të parë, shqyrton kërkesën dhe projektin e marrë, përputhjen e përmbajtjes së statutit me aktivitetin për të cilin do të kërkohet liçencim dhe merr vendim për miratimin apo udhëzon ndonjë ndryshim në të dhënat e statutit.

Vendimi i dërgohet aplikuesit brenda pesë ditë pune dhe është pjesë e praktikës që depozitohet në Regjistrin Tregtar.

Miratimi i Statutit nuk kushtëzon Autoritetin në marrjen e vendimeve të mëvonshme në lidhje me liçencimin e të njëjtit subjekt si Treg i Letrave me Vlerë.

Neni 6 Objekti i statutit

Statuti i kërkuarit për liçencë ka si objekt të vetëm aktiviteti, krijimin dhe veprimtarinë e tregut të letrave me vlerë.

Neni 7 Rregullat e funksionimit të tregut

Rregullat e funksionimit të tregut të letrave me vlerë përfshijnë:

1. Rregullat e funksionimit të Bordit Mbikëqyrës të tregut;
2. Rregullat lidhur me anëtarësinë;
3. Rregullat lidhur me listimin;

4. Rregullat lidhur me mënyrën e tregtimit në tregun e letrave me vlerë,
5. Rregullat lidhur me pjesëmarrjen minimale dhe mjaftueshmërinë e kapitalit;
6. Rregullat lidhur me njoftimet, raportimet periodike, raportimet për të gjitha transaksionet;
7. Rregullat lidhur me pastrimin e rregullimin e transaksioneve;
8. Rregulla të tjera që Bordi Mbikëqyrës dhe Bordi I AMF-së i gjykon të nevojshme.

Neni 8

E drejta e Autoritetit për të kërkuar ndryshime

Autoriteti mund të kërkojë të bëhen ndryshime në statutin e shoqërisë, në rregulloret e funksionimit të tregut si dhe në dokumentacionin tjetër plotësues, me qëllim mbrojtjen e investitorëve dhe transparencën e tregut. Tregu i letrave me vlerë është i detyruar të zbatojë udhëzimet e Autoritetit.

Dispozitat e paragrafit të mësipërm janë të vlefshme dhe pas marrjes së licencës për funksionimin e tregut të letrave me vlerë.

KREU III

PROCEDURA E LIÇENCIMIT

Neni 9

Formë kërkesa

Kërkuesi për licencë, plotëson formë kërkesën e miratuar nga Bordi i Autoritetit sipas aneksit 1 bashkëngjitur kësaj rregulloreje.

Formë-kërkesa shoqërohet nga kërkesa me shkrim për marrjen e licencës provizore për të vepruar si treg letrash me vlerë, nga dokumentacioni i kërkuar në nenin 10 të kësaj rregulloreje, si dhe nga vertetim pagesa e kuotës përkatëse parashikuar në nenin 19 të kësaj rregulloreje.

Neni 10

Dokumentacioni për marrjen e licencës provizore

Për marrjen e licencës provizore si treg letrash me vlerë, subjekti kërkues duhet të paraqesë pranë Autoritetit dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Aktin e themelimit, statutin e shoqërisë si dhe vendimin e gjykatës për regjistrimin si shoqëri tregtare;
- b) Emërimin e drejtorit/drejtorëve të shoqërisë;
- c) Emërimet e anëtarëve të Bordit të tregut të letrave me vlerë dhe të dhëna mbi aftësitë profesionale të tyre;
- d) Një listë të aksionerëve si dhe të kuotave të zotëruara prej tyre;
- e) Deklarata personale të personelit drejtues, që plotësojnë të gjitha kushtet e parashikuara në nenin 16 të kësaj rregulloreje;
- f) Curriculum Vitae dhe dokumentat që vërtetojnë përfundimin e arsimit të lartë përkatës nga personeli drejtues sipas pozicionit të punës që mbulojnë;
- g) Të dhëna të detajuara për hapësirën ku do të zhvillojë veprimtarinë.

Neni 11

Shqyrtimi i praktikës dhe

dhënia e liçencës provizore nga Autoriteti

Bordi i Autoritetit brenda 30 ditëve nga dorëzimi i formë kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues të plotë sipas nenit 10, merr në shqyrtim praktikën.

Bordi i Autoritetit merr vendim në lidhje me miratimin ose refuzimin e dhënies së liçencës provizore dhe brenda 5 ditëve nga marrja e vendimit njofton me shkrim kërkuuesin për vendimin e tij.

Neni 12

Rregullat e Funksionimit dhe Dokumentacioni për Liçencimin Përfundimtar

Brenda gjashtë muajve nga miratimi i liçencës provizore, Tregu i Letrave me Vlerë, i paraqet për miratim Bordit të Autoritetit:

- 1- Rregullat e funksionimit të parashikuar në nenin 7 të kësaj rregulloreje.
- 2- Kopje të marrëveshjeve të lidhura me jo më pak se tre tregtarë të liçencuar për të vepruar me letrat me vlerë;
- 3- Kopje të marrëveshjeve të lidhura me ofruesit e liçencuar të shërbimeve të pastrimit, të rregullimit të llogarive dhe të regjistrimit e të publikimit të transaksioneve, në rast se tregu nuk pranon që ta bëjë vetë pastrimin dhe rregullimin e llogarive nëpërmjet krijimit të një strukture të veçantë të tij;
- 4- Sistemin e komunikimit me Komisionin;
- 5- Të dhëna të detajuara për paisjet që do të përdoren, shkallën e automatizimit të veprimtarisë, sistemin e sigurisë, sigurimin e energjisë elektrike, pajisjet komunikuese që duhen vënë në dispozicion, etj;
- 6- Dokumentacionin që vërteton se ka personelin e nevojshëm për mirëmbajtjen e pajisjeve të veçanta;
- 7- Një plan biznesi për tre vitet e para të aktivitetit, në të cilin të detajohet pritshmëria e aktivitetit të tregut i ndarë në vite.
- 8- Të dhëna në lidhje me gjendjen financiare dhe burimet financiare për të përballuar këtë aktivitet për një periudhë të paktën tre-vjeçare;
- 9- Sistemin e brendshëm të kontrollit;
- 10- Dokumenta të tjera që Komisioni i gjykon të arsyeshme.

Bordi brenda 30 ditëve nga dorëzimi i rregullave, merr në shqyrtim praktikën dhe vendos në lidhje me miratimin si dhe dhënien e liçencës përfundimtare. Brenda 5 ditëve njofton me shkrim kërkuuesin për vendimin e tij.

Neni 13

Dorëzimi i dokumentacionit

Deri në plotësimin e dokumentacionit për secilën nga fazat e liçencimit, kërkuesi për liçencë komunikon me Departamentin e Liçencimit dhe Monitorimit të Autoritetit, për korrigjimin ose plotësimin e dokumentacionit të dorëzuar.

Përfaqësues të Administratës së Autoritetit gëzojnë të drejtën e verifikimit faktik të sistemeve të ndryshme operative të subjektit kërkuës, si dhe mund të bëjnë kërkesa ose rekomandime për përmirësimin ose përshtatjen e masave të marra. Kërkuesi i liçencës është i detyruar të plotësojë kërkesat e bëra.

Afatet për shqyrtimin e praktikave nga Autoriteti fillojnë në ditën kur Departamenti i Liçencimit dhe Monitorimit, vlerëson se dokumentacioni është i plotë dhe janë respektuar kërkesat dhe rekomandimet e bëra për përmirësimin e punës.

KREU IV TË NDRYSHME

Neni 14 Detyrimi për informim

Tregu i letrave me vlerë i paraqet Autoritetit raporte mujore mbi mbarëvajtjen e aktivitetit të tij, të miratuara nga Drejtori Ekzekutiv i Shoqërisë. Ky raport duhet të paraqitet brenda 1 jave nga mbarimi i muajit për të cilin raportohet*.

Tregu i letrave me vlerë i paraqet Autoritetit raporte gjashtëmujore dhe vjetore mbi mbarëvajtjen e aktivitetit të tij, të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës i tregut të letrave me vlerë. Ky raport duhet të paraqitet brenda 2 muajve nga mbarimi i periudhës për të cilën raportohet.

Autoriteti, në çdo rast mund t'i kërkojë të licencuarit, informacion të përgjithshëm ose të dhëna për çështje të veçanta të lidhura me aktivitetin e tij si treg letrash me vlerë.

Bordi Mbikëqyrës i Tregut, në mbledhjet e tij mund të ftojë përfaqësues të Autoritetit që të asistojnë në mbledhje pa të drejtë vote.

Neni 15 Ndryshimi i rregulloreve të tregut

Kur Bordi Mbikëqyrës i tregut të letrave me vlerë gjykon se është e nevojshme të bëhen ndryshime në rregullat e tij, i paraqet Autoritetit për miratim një projekt me ndryshimet e propozuara.

Autoriteti, brenda 14 ditëve miraton ose kundërshton me shkrim, pjesërisht ose plotësisht, të gjitha ndryshimet e propozuara. Ndryshimet e propozuara dhe të pranuar sipas këtij paragrafi hyjnë në fuqi nga data e pranimit të tyre. Nëse ndryshimet e propozuara nuk kundërshtohen brenda 14 ditëve, miratimi do të konsiderohet i dhënë dhe efektet e tij juridike fillojnë në datën kur mbaron afati 14-ditor.

Neni 16 Kërkesa dhe kufizime për drejtuesit e tregut

Drejtuesit e shoqërisë duhet të plotësojnë këto kërkesa:

- të ketë arsimin e lartë përkatës sipas pozicionit të punës së parashikuar;
- të kenë eksperiencë pune të paktën tre-vjeçare, në përputhje me specialitetin për të cilin është diplomuar;
- të kenë punuar më parë në poste drejtuese;
- të jenë të pajisur me të paktën 3 referenca pozitive nga punëdhënësit e kaluar.

Nuk mund të punësohet me cilësinë e Drejtorit pranë një shoqërie, e cila synon të ushtrojë aktivitetet si treg letrash me vlerë, personi që:

- është dënuar më parë për vepra penale të parashikuara nga Kodi Penal;
- i është hequr e drejta për të ushtruar detyra shtetërore;
- i është hequr e drejta për të ushtruar detyra drejtuese;
- është shpallur i falimentuar;
- gjykata ka vendosur nxjerrjen jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 17

Refuzimi i dhënies së liçencës

Autoriteti mund të refuzojë kërkesën për dhënien e liçencës, nëse subjekti kërkues nuk paraqet dokumentacionin e kërkuar nga kjo rregullore ose nuk bën plotësimet ose korigjimet e nevojshme sipas kërkesës së Autoritetit.

Neni 18 Tërheqja e liçencës

Autoriteti mund të tërheqë një liçencë për tregun e letrave me vlerë, në qoftë se:

- a) shoqëria ndalon veprimtarinë në tregun e letrave me vlerë;
- b) shoqëria është shpallur në gjendje falimentimi nga gjykata;
- c) shoqëria vepron në kundërshtim me interesin publik;
- d) nuk paguhet detyrimi vjetor ndaj Autoritetit.

KREU V DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 19 Kuotat dhe komisionet

Autoriteti aplikon këto kuota për kërkesën për liçencë dhe për akordimin e liçencës:

- a) Kuota që paguhet në momentin e dorëzimit për shqyrtim të dokumentacionit për marrjen e liçencës provizore nga subjekti kërkues është 20.000 (njëzetmijë) lekë;
- b) Kuota për dhënien e liçencës përfundimtare për funksionimin si treg letrash me vlerë është 100.000 (njëqindmijë) lekë;
- c) Tregu i letrave me vlerë, paguan një kuotë prej 150.000 (njëqind e pesëdhjetëmijë) lekë, për çdo vit ushtrimor të aktivitetit. Pagesa e kësaj kuote do të bëhet brenda muajit që operatorit i është dhënë liçenca dhe po në këtë muaj të çdo viti në vazhdim.

Neni 20 Regjistrimi dhe publikimi i liçencës

Autoriteti mban regjistër të veçantë për personat e regjistruar për të vepruar si treg letrash me vlerë. Në regjistër shënohet emri, adresa, emrat e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, Drejtorëve, emrat e aksionerëve si dhe mbahen shënime për ndryshime të këtyre të dhënave.

Dhënia e liçencës për të vepruar si treg letrash me vlerë, publikohet në një ose me shumë gazeta kryesore me tirazh të madh.

Neni 21 Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi, në ditën e miratimit të saj nga Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

Dispozitat që bien në kundërshtim me këtë rregullore, shfuqizohen.

Elisabeta GJONI
KRYETAR